



NJOFTIM PËR SHTYP

Mbrojtja e të drejtave të njeriut për të Burgosurit e Huaj brenda vendit në ambientet multi-etnike të vuajtjes së dënimit

Raporti ndërkombëtar mbi vlerësimin e nevojave për trajnimin e stafit të burgjeve - i sapo publikuar nga projekti i financuar nga BE, B-COMPETENT - thekson pikat e dobëta, praktikat e mira dhe nevojat për trajnim të stafit civil të burgjeve në gjashtë vende.

Dhjetor 2020 – Kërkimi shkencor ndërkombëtar, i përgatitur nga Universiteti i Barcelonës - OSPDH, vjen si rezultat i raporteve dhe sondazheve kombëtare të zhvilluara nga organizatat partnere në Shqipëri, Francë, Greqi, Itali, Mal të Zi dhe Spanjë, të zhvilluara nga shkurti deri në tetor 2020, në kuadër të projektit të BE-së, “B-COMPETENT. Përmirësimi i kompetencave të stafit penitenciar në Evropë”. Pavarësisht sfidave të hasura nga kërkuesit për shkak të situatës nga COVID-19, B-COMPETENT ka arritur të përmbushë me sukses qëllimin për vlerësimin e plotë lidhur me nevojat dhe mangësitë për trajnim të stafit të burgjeve në këto gjashtë vende.

Shqipëria - Në raportin për Shqipërinë janë theksuar nevojat kryesore për trajnime si: i) numri i kufizuar i personelit civil dhe i përkthyesve; ii) trajnimi i vazhdueshëm zhvillohet kryesisht për stafet e sigurisë në burgje, ndërsa trajnimi i stafit civil nuk është një praktikë e strukturuar. Duhet të sigurohet një fond i dedikuar për përkthyes në mënyrë që të sigurohet mbështetje për të burgosurit e huaj. Trajnerët janë profesionistë, por programet e trajnimit nuk rishikohen rregullisht dhe kjo shkakton mbivendosje të përmbajtjes së trajnimit dhe kurrikulës.

SHQIPËRIA: FOKUSI I VENDIT

Administrata e burgut duhet të ketë burime të mjaftueshme financiare për të përmirësuar kushtet e jetesës, aktivitetet sociale, si dhe trajnimin sa më efektiv dhe të posaçëm në lidhje me situatën dhe nevojat specifike të të burgosurve të huaj.

Francë - Mungesa e përgjithshme e trajnimeve të përshtatshme tregon se trajnimi i stafit për çështjen e të burgosurve të huaj është i dobët. Administrata e burgut në Francë ndihmohet nga organizata siç është La Cimade, e cila siguron ndihmë dhe këshilla për të burgosurit e huaj. **Në praktikën e trajnimeve të këtyre stafeve nuk sigurohet akses i qëndrueshëm për të burgosurit e huaj.**

METODOLOGJIA

Metodologjia që u zbatua për hartimin e Raporteve Kombëtare u bazua në: 1) analizën e programeve ekzistuese të trajnimit; 2) sondazhe online dhe offline për autoritetet e burgjeve, menaxherët e burgjeve, stafin e burgjeve dhe stafin civil të burgjeve të vijës së parë; 3) fokus grupet.

Zhvillimi i 9 fokus grupeve dhe shpërndarja e më shumë se 500 pyetësorëve

HAPAT E RRADHËS:

- Hartimi dhe zhvillimi i një kursi e-learning;
- Broshura shumëgjuhëshe për stafin civil të burgjeve;
- Prodhimi i videove të animuara me skenarë të rasteve e çështjeve praktike;
- Organizimi i 6 workshope-ve ndërkufitare të trajnimit të trajnerëve në Itali, Shqipëri, Spanjë, Mal të Zi, Greqi dhe Francë.

PARTNERË:



B-ComPetent është një projekt i bashkëfinancuar nga Programi për Drejtësinë i Bashkimit Evropian, GA. nr. 854040. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e Komisionit Evropian.

GREQIA: FOKUSI I VENDIT

Ky raport nënvizon nevojën për të zhvilluar politika për rekrutimin e stafit dhe për të ri-organizuar si trajnimin fillestar ashtu edhe trajnimin e vazhdueshëm për oficerët e burgjeve. Nevojitet përgatitja e programeve të trajnimit të strukturuar, kurseve, programeve dhe manualeve të trajnimit.

Greqia - Stafi administrativ i burgjeve, përfshi stafin civil, kanë diploma të arsimit universitar ose diploma gjimnazi, të cilët emërohen në detyrë pa marrë ndonjë trajnim në lidhje me sistemin e vuajtjes së dënimit, administratën e tij, organizatën shoqërore të burgjeve, rolin profesional të stafit të burgjeve, etikën, etj. Kohëzgjatja e trajnimit është zvogëluar vazhdimisht për shkak të mungesës së burimeve,

ndërsa disa punonjës nuk kanë ndjekur asnjë kurs trajnimi, pasi shkolla e trajnimit nuk është një strukturë e përhershme.

Italia – Trajnimet zhvillohen më tepër për policinë e burgjeve, për shkak të numrit më të madh të stafit të sigurisë krahasuar me punonjësit civil. Trajnimet përfshijnë nocione rreth të drejtave themelore të të burgosurve dhe praktikave më të mira në jetën e përditshme në burg, por njohuritë dhe aftësitë multikulturore nuk adresohen si duhet.

ITALIA: FOKUSI I VENDIT

"Mëkati" i administratës italiane së burgjeve është disproporcioni midis njësive të personelit të burgjeve dhe numrit të përgjithshëm të të burgosurve si dhe përputhja me dispozitat e Rec. 1999 (22) të KE, në lidhje me mbipopullimin dhe rritjen e popullsisë në burgje.

Mali i Zi - Kurset e trajnimit jo të detyrueshme, si dhe mangësitë për ofrimin e tyre janë mjaft evidente në Malin e Zi, ku përmes zhvillimit të sondazheve u nënvizuan këto mangësi: i) stafi i burgjeve nuk ndjek trajnime para se të nisë detyrën; ii) nuk ka staf të dedikuar për të punuar me të burgosurit e huaj; iii) mungesa të trajnimeve për të drejtat e të burgosurve të huaj, mbi larmishmërinë kulturore dhe nevojat e veçanta të tyre.

SPANJA: FOKUSI I VENDIT

Administrata katalanase krijoi Shërbimet e Orientimit dhe Pritjes, qëllimi kryesor i të cilave ishte të lehtësonte komunikimin ndërmjet të burgosurve të huaj dhe punonjësve të burgjeve përmes lehtësirave të interpretimit dhe përkthimit për FNP-të.

Spanja - Që prej vitit 2002, shërbimet e burgjeve të Katalonjës kanë pasur përmirësime strukturore, organizative dhe socio-arsimore për të përmbushur nevojat e FNP-ve. CEJFE ofron një trajnim online mbi çështjet e migracionit që synojnë njësitet e menaxhimit të burgjeve, por kursi adreson vetëm çështje ligjore. Në vitin 2020, ndër trajnimet e ofruara, nuk ka pasur asnjë temë lidhur me trajtimin të burgosurve të huaj.

REKOMANDIME KYÇE

1. Sigurimi i kurseve të gjuhës për të burgosurit e huaj duke iu mundësuar atyre komunikim më efektiv me stafin e burgjeve.
2. Të ketë qasje të përshtatshme për krijimin e lehtësirave në interpretim dhe përkthim për të burgosurit e huaj.
3. Përgatitja e stafit të burgjeve me aftësi të veçanta për të punuar si duhet me të burgosurit e huaj (në çdo burg duhet të ngrihet një zyrë qendrore për t'u marrë me nevojat dhe problemet e veçanta të të burgosurve dhe për të zgjidhur konfliktet).
4. Pajisja e stafit të burgjeve me kompetenca dhe me aftësi të përshtatshme në lidhje me:
 - (a) standardet dhe rregulloret ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat dhe nevojat e veçanta të të burgosurve të huaj;
 - (b) mekanizmat për të mbajtur parasysh kontekstin e njohur shoqëror dhe kulturor të të burgosurve të huaj.

Raportin e plotë mund ta gjeni:
www.bcompetent.eu

Ndiqui B-ComPetent në profilet e zyrtare të:



NA KONTAKTONI:
info@bcompetent.eu